




REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA GLLOGOC GLLOGOC MUNICIPALITY			
Pranuar	01.03		2010
Nj. Org *	Numër	Shtojca	Vlera
01	344-	2519	



REPUBLIKA E KOSOVËS Kuvendi Komunal -Drenas

Në vështrim të nenit 58 germa (h) të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale , nenit 6 dhe 19.2 germa (c) të Ligjit nr.02/L-127 për Transportin Rrugor, nenit 72 germa (h) të Statutit të Komunës së Drenasit dhe nenit 12 të Rregullores Komunale për Transportin Rrugor, Kuvendi Komunal në mbledhjen e mbajtur me :19.02.2010 miratoi këtë:

V E N D I M

PËR VAZHDIMIN E LEJEVE TË OPERIMIT NË TRANSPORTIN PUBLIK TË UDHËTARËVE NË LINJAT PERIFERIKE TË KOMUNËS ME AUTOBUS, KOMBI TAXI DHE AUTO TAXIVE NË TERITORIN E KOMUNËS SË DRENASIT PËR VITIN 2010.

Neni 1

Me këtë VENDIM aprovohet propozimi i Drejtorisë për SHP&E-cë që të vazhdohen lejet e Operimit të transportuesve publik të udhëtarëve në linjat periferike në territorin e Komunës me autobus, kombitaxi dhe autotaxive. Lejet e operimit lejohen vetëm në territorin e Komunës për vitin 2010, sipas rendit të udhëtimit të vitit 2009 për transportuesit publik me autobus dhe linjat që do të caktohen në bazë të nevojave të udhëtarëve me kombi-taxi, në vijat periferike në territorin e Komunës.

Neni 2

Transporti publik i udhëtarëve me kombitaxi lejohet në të gjitha vijat që nuk janë të mbuluara përkatësisht nuk kryhet transporti publik i udhëtarëve me autobus sipas rendit të udhëtimit, ku ka interval të lejuar ligjor të kohës të përpiluar nga Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencë i Komunës.

Neni 3

Vazhdimi i Lejeve të operimit të operatoreve transportues jepet kundrejt pagesës sipas Tarifës Komunale.

Neni 4

Ekzekutimin e këtij Vendimi e bënë Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë ndërsa për zbatimin e tij do të jetë kompetent e Drejtoria për Inspeksion e KK Drenasit.

Neni 5

Ky Vendim hynë në fuqi nga dita e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Drenasit ndërsa aplikohet nga data 01.01.2010.



Kryetari i Kuvendit të Komunës

Fatmir Isatogu